

VENDIM
Nr.69, datë 27.1.2006

**PËR MËNYRËN E LLOGARITJES SË TRAJTIMIT TË VEÇANTË FINANCIAR TË
EFEKTIVAVE, OFICERË DHE NËNOFICERË, LUNDRUES TË NËNDETËSEVE DHE
POLUMBARËVE TË FORCAVE DETARE, NË PENSION**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3 e 8 të ligjit nr.9361, datë 24.3.2005 “Për një trajtim të veçantë financiar të efektivave, oficerë dhe nënoficerë, lundruer të nëndetësve dhe polumbarëve të Forcave Detare, në pension”, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes dhe të Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Për efekt të llogaritjes, caktimit dhe pagesës së shtesës mbi pension, si trajtim i veçantë financiar, në zbatim të ligjit nr.9361, datë 24.3.2005 “Për një trajtim të veçantë financiar të efektivave, oficerë dhe nënoficerë, lundruer të nëndetësve dhe polumbarëve të Forcave Detare, në pension”, personat e interesuar të tërheqin nga drejtoria rajonale e sigurimeve shoqërore dy formularë kërkesë për përfitim, të cilat t’i dorëzojnë në repartin ku kanë ndërprerë marrëdhëniet financiare apo në Komandën e Forcave Detare, kur reparti është suprimuar.

1.1 Dokumentacioni i nevojshëm për përfitimin e trajtimit të veçantë financiar të përgatitet nga komandat e reparteve ushtarake dhe të dërgohet në Ministrinë e Mbrojtjes, e cila, pasi ta shqyrtojë, ta dërgojë atë në drejtorinë rajonale të sigurimeve shoqërore të vendbanimit përkatës.

2. Për llogaritjen e trajtimit të veçantë financiar, të merret si bazë paga referuese, e cila përbëhet nga paga bazë për gradë, sipas viteve të shërbimit të ushtarakut aktiv të së njëjtës gradë, në çastin e lindjes së të drejtës për këtë trajtim të veçantë financiar.

Për efekt të llogaritjes së pagës referuese të merret funksioni, grada e fundit si lundruer nënues.

3. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të cilat për vitin 2005 llogariten në shumën 7 000 000 (shtatë milionë) lekë, të përballohen nga buxheti i vitit 2006, miratuar për Institutin e Sigurimeve Shoqërore.

4. Ministri i Mbrojtjes dhe Drejtori i Institutit të Sigurimeve Shoqërore, brenda 30 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, të nxjerrin udhëzimin e përbashkët dhe dokumentacionin tip për zbatimin e tij.

5. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta dhe Instituti i Sigurimeve Shoqërore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga 1.1.2006.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha